



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

1239
07.03.2016

Nr. Rregj. Them. 7254/2690/597

Nr. Vendimit 349

Data e rregjistrimit 17.09.2014

Data e vendimit 25.02.2016

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Lindita SINANAJ	Kryesuese
Artur MALAJ	Anëtar
Alkelina GAZIDEDJA	Anëtare

me sekretare gjyqësore *Visela Kashari*, në Tiranë, sot në datë 25.02.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative, që i përket palëve:

PADITËS: *Shoqëria "Neli-Osoje" shpk*, me NIPT K 99114401E,
me seli në fshatin Cerenisht, Skrapar.

TE PADITUR: *Drejtoria Rajonale Tatimore Berat.*
Drejtoria e Apelit Tatimor.

OBJEKTI: Shfuqizim i akteve administrative.
-Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. 2925,
datë 05.11.2013.
-Vendim nr. 21284/2, datë 18.02.2014.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 43, 328 dhe 331 pikat 3 e 4 të K.Pr.Civile.
Neni 109 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në RSH*"

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi dëgjoji relacionin e kryesueses së trupit gjykues, shqyrtoi ankimin e paraqitur nga pala paditëse, shoqëria "Neli-Osoje" shpk, që kërkon:

-ndryshimin e vendimit nr. 634 datë 05.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe pranimin e padisë si të mbështetur në prova dhe në ligj.

dhe bisedoi çështjen në tërësi:

VËREN

Në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 17.09.2014 është regjistruar ankimi i paraqitur nga pala paditëse Shoqëria "Neli-Osoje" shpk, kundër vendimit nr. 634, datë 05.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, bazuar në nenet 442, 443 e vijues të K.Pr.Civile dhe nenin 48 të ligjit nr. 49/2012 "*Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative*". Ky ankim është paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në datën 10.06.2014. Kjo gjykatë me vendimin e datës 19.06.2014, ka bërë verifikimin e kushteve për pranimin e ankimit duke e dërguar atë për shqyrtim së bashku me aktet e dosjes, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Nga aktet e dosjes së gjykimit rezulton se në datën 20.03.2014, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me padinë objekt gjykimi. Kjo Gjykatë, me vendimin nr. 634, datë 05.05.2014 ka vendosur: "*Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj e në prova. Shpenzimet gjyqësore palës iniciuese të këtij gjykimi. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15-ditëve nga e nesërmeja e shpalljes më Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, afat i cili për palën në mungesë fillon nga dita e nesërme e marrjes dijeni mbi këtë vendim.*"

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse Shoqëria "Neli-Osoje" shpk, duke parashtruar këto pretendime:

- ✓ Vendimi i gjykatës është në kundërshtim të plotë me ligjin dhe në interpretim të gabuar të tij.
- ✓ Gjykata nuk ka interpretuar saktë elementët e nenit 7 pika "a" të ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative".
- ✓ Gjykata bazuar në nenin 35/3 të ligjit nr. 49/2012 duhet të verifikonte pretendimet e palëve ndërgjyqëse nëse ishin të vërteta apo jo.
- ✓ Drejtoria e Apelit Tatimor pa marrë parasysh asnjë argument tonin në vendimin e saj nr. 21284/2, datë 18.02.2014 e ka lënë në fuqi penalitetin me arsyetimin se nuk kemi dokumentacionin e plotë për të provuar të kundërtën.

Për sa më sipër ankuesi ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 634, datë 05.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe pranimin e kërkesë padisë.

Parashtrimi i rrethanave të faktit

Pala paditëse, shoqëria "Neli-Osoje" shpk, është me seli në fshatin Cerenisht, Skrapar dhe operon në fushën e shfrytëzimit të pyjeve e pajisur me leje mjedisore. Ky subjekt në datën 07.11.2013 është vënë në dijeni nëpërmjet shërbimit postar në lidhje me njoftim vlerësimin nr. 2952, datë 05.11.2013 në lidhje me një penalitet të vendosur nga ana e sigurimeve shoqërore në masën 250.000 lekë. Ky detyrim është vendosur nga sektori i vlerësimit, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, bazuar në aktin e verifikimit nr. 001118, datë 09.09.2013 dhe proces-verbalin e konstatimit datë 09.09.2013 të Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit të Punës Skrapar. Arsyeja e vendosjes së këtij penaliteti ka qënë mosregjistrimi i punonjësës Vera Muçaj, në skemën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Ky vlerësim është kryer në bazë të shkresës nr. 273 prot., datë 09.10.2013 të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe referuar kësaj shkrese inspektorja e Drejtorisë së Përpunimit dhe Menazhimit të të Ardhurave në DRT-Berat, ka kryer verifikimin e listëpagesës së dorëzuar në organin tatimor nga tatimpaguesi shoqëria "Neli-Osoje" shpk, ku rezultoi se ky subjekt nuk ka deklaruar pranë këtij organi punonjësën Vera Muçaj.

Pala paditëse nuk ka qënë dakort me këtë akt administrativ dhe e ka ankimuar atë pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, e cila me vendimin nr. 21284/2 datë 18.02.2014 ka lënë në fuqi

këtë akt administrativ me arsyetimin se nuk provohet e kundërta e asaj që është provuar në aktin e konstatimit. Duke mos qënë dakort me këtë vendim pala paditëse, shoqëria "Neli-Osoje" shpk, i është drejtuar gjykatës me kërkesë padinë objekt gjykimi.

Vlerësimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit

Së pari gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7 gërma "a", nenit 10 paragrafi 2 gërma "a" dhe nenit 44 të ligjit nr. 49/2012, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Së dyti në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se ankimi nuk është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 49/2012 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative*" dhe për këtë arsye duhet vendosur mospranimi i tij për shqyrtim. Nga rrethanat e çështjes konstatohet se pala paditëse kërkon me padinë objekt gjykimi, shfuqizimin e aktit, njoftim vlerësimi nr. 2925, datë 05.11.2013 të DRT Berat dhe vendimit nr. 21284/2, datë 18.02.2014 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor. Pra, objekti i padisë në shqyrtim përmban dy kërkime, në njërin kërkohet shfuqizimi i aktit administrativ njoftim vlerësimi dhe në tjetrin kërkohet shfuqizimi i vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, i cili e ka lënë në fuqi aktin administrativ njoftim vlerësimi. Konstatohet se akti administrativ njoftim vlerësimi nr. 2925, datë 05.11.2013, objekt kundërshtimi përmban detyrimin e palës paditëse për pagimin e shumës në të holla konkretisht prej 250.000 lekë.

Referuar nenit 45 gërma "b" të ligjit nr. 49/2012 në të cilin përcaktohet se: "*Nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi*", konstatohet se një nga kushtet e pranueshmërisë së ankimit është edhe vlera e detyrimit në të holla që përmban akti i kundërshtuar.

Paga minimale në shkallë vendi rezulton të jetë përcaktuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 573 datë 03.07.2013. Në pikën 1 të këtij vendimi është përcaktuar se "*Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga cdo person juridik a fizik, vendas a i huaj, të jetë 22.000 (njëzet e dy mijë) lekë.*" Duke llogaritur njëzetfishin e kësaj page, konstatohet vlera 440.000 (katërqind e dyzet mijë) leke. Kjo shumë

përbën kufirin minimal të detyrimit në të holla që duhet të përmbajë akti administrativ objekt kundërshtimi në gjykatën administrative, që të legjitimohen palët ndërgjyqese në paraqitjen e ankimit kundër vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Në rastin në shqyrtim detyrimi në të holla që përmban akti objekt kundërshtimi, është dukshëm më i vogël se shumica e lejuar prej 440.000 lekë. Sipas gërmës "a" të nenit 50 të ligjit nr. 49/2012, Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos: "*mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë*". Në këto kushte Gjykata Administrative e Apelit, duke vlerësuar se nuk plotësohet një prej kushteve të pranueshmërisë së ankimit, referuar nenit 50 gërma "a" të ligjit nr. 49/2012 duhet te vendose mospranimin e ankimit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 49 e 50 gërma "a" të ligjit nr.49/2012
"Për Organizimin edhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative",

VENDOSI

Mospranimin e ankimit të paraqitur ndaj vendimit nr. 634, datë 05.05.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Tiranë më 25.02.2016.

ANËTARE

Alkelina GAZIDEDJA
dv

ANËTAR

Artur MALAJ
dv

KRYESUESE

Lindita SINANAJ
dv

Vertetohet njesia me origjinalin

cancelu
Leonard Shari
Beqir